



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Ekspozimin Shkencor në Detin Mesdhe”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Jurgi Çyrbja, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Artemis Dralo, Ralf Gjoni dhe Arlind Çaçani

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Blendi Klosi – Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Si fillim do të miratojmë procesverbalin e mbledhjes të datës 31 tetor të vitit 2019 të Komisionit të Ligjeve. A ka ndonjë vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Ligjeve të datës 31 tetor të vitit 2019

Si pikë të dytë të rendit të ditës, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Ekspozimin Shkencor në Detin Mesdhe”. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Adnor Shameti.

Sot prezent kemi ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, zotin Blendi Klosi. Zoti Klosi, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk besoj se është në kushtet e konfliktit të interesit.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Klosi, ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për koleget e mi deputetë, por edhe për opinionin publik. Më pas fjalën e ka zoti Shameti dhe më pas do t’u kaloj fjalën kolegëve, nëse do të kenë diçka për të shtuar, para se ta votojmë në parim dhe në tërësi.

(Diskutime pa mikrofon)

Kolegë, ju lutem, pasi të mbarojmë mbledhjen e komisionit, jeni të lirë ta vazhdoni bisedën!

Fjala është për ju, zoti Klosi.

Blendi Klosi – Mirëdita kolegë!

Faleminderit për organizimin e kësaj dëgjese për sa i përket këtij projektligji!

Ky projektligj është në kuadër të të gjitha politikave që Ministra e Turizmit dhe Mjedisit po ndërmerr për të promovuar turizmin e detit apo, siç e kemi etiketuar, “turizmi blu”. Konventa në të cilën ne do të aderojmë nëpërmjet këtij projektligji është Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe. Kjo është një mënyrë shumë e mirë

që edhe Shqipëria, pas një eksperience të gjatë që ka ky Komision Ndërkombëtar, të aderojë për të qenë pjesë e një diskutimi së bashku me vendet e tjera të zonës së Mesdheut për sa u përket problematikave dhe studimeve shkencore në Detin Mesdhe. Ajo çfarë dua të ndaj me ju, të nderuar kolegë deputetë, është se kjo konventë është ndërtuar nga princi i Monakos, Alberti II, për t'i mbledhur së bashku ekspertët e mjedisit të të gjitha vendeve të Mesdheut. Shqipëria është një nga vendet e fundit që aderon në këtë konventë, në mënyrë që edhe ajo të ketë mundësinë e shfrytëzimit të bukurisë së madhe që ka zona e Mesdheut dhe kjo t'i bashkëngjitet edhe mendimit shkencor. Ne në Shqipëri e kemi realisht të nevojshme që të jemi pjesë e këtij diskutimi, pasi nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, nëpërmjet aderimit në këtë konventë, të kemi mundësi të bëhemi pjesë e diskutimit shkencor dhe të kemi mundësi që nëpërmjet projekteve të zhvilluara gjerësisht nga partnerët anëtarë të kësaj konvente të përfitojmë dhe të jemi pjesë e projekteve më të mëdha kërkimore-shkencore në zonën e Mesdheut.

Të nderuar kolegë deputetë, ne duam shumë që ta zhvillojmë turizmin blu në Shqipëri, ne duam shumë që dimensionin e turizmit marinë, dimensionin e turizmit detar të aktivizohet në Shqipëri. Realisht, jemi në fazat e para, sepse kemi bërë një punë të madhe dhe mendoj se kemi ecur shumë mirë për sa i përket turizmit klasik në vendin tonë. Ne flasim shumë për turizmin e detit, flasim shumë për turizmin malor, flasim për trashëgiminë kulturore, për trashëgimitë natyrore, për site, për qytete të vizituara, flasim shumë për plazhet, por flasim shumë pak për turizmin detar. Ajo çfarë ne po ndërtojmë tani si ministri është një përpjekje e përgjithshme për të aderuar në përpjekjet e vendeve të tjera të rajonit për sa i përket turizmit në marinë dhe turizmit të detit.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe do të na ndihmojë shumë që të jemi pjesë e kësaj bisede. Në qoftë se ne do të arrijmë nëpërmjet anëtarëve themelues dhe aderues të kësaj konvente të futemi në rrjet që të diskutojmë për detin, për mënyrën se si zhvillohet deti dhe se si ofrohet ai si destinacion turistik, mendoj se do të kemi një nga arritjet e mëdha të filozofisë sonë për të hapur turizmin detar dhe për të qenë pjesë e një tryeze, ku diskutohen të fundit nga shkenca.

Të nderuar kolegë deputetë, është fakt që kemi diçka të pandashme me vendet e rajonit, që është deti. Në qoftë se në Shqipëri për të zhvilluar turizmin tokësor dhe turizmin e plazhit duhet infrastrukturë më e madhe, duhen kushte më të mëdha dhe më tepër investime, po të flasim për turizmin detar jemi në të njëjtat kushte, sepse deti është i njëjtë si për një vend të vjetër europian si Italia, ashtu edhe për një vend të ri europian si Kroacia apo Sllovenia, si për vend aderues si Mali i Zi, ashtu edhe për një vend europian si Greqia apo për një vend aspirues

si Shqipëria. Prandaj, duke qenë pjesë e kësaj tryeze, duke qenë pjesë e këtij biznesi, mendoj se do të kemi shumë sukses dhe do t'ia dalim që jo vetëm ta promovojmë Detin Mesdhe si destinacion turistik, por ta shikojmë edhe nga pikëpamja shkencore. Ne do t'u japim të drejtën shkencëtarëve dhe ambientalistëve shqiptarë të jenë pjesë e kësaj tryeze shumë interesante, siç është tryeza shkencore për Detin Mesdhe dhe të bëhemi më shumë pjesë e debatit për të fundit nga shkenca, po ashtu edhe për problematikat që ka ky lloj turizmi në Shqipëri dhe në Mesdhe.

Kjo konventë është relativisht e thjeshtë, por për ne është shumë sinjifikative, sepse do të kemi mundësi që nëpërmjet saj shkencëtarët shqiptarë, ambientalistët shqiptarë, si dhe ideatorët e turizmit marinë të vendit tonë të jenë pjesë me të drejta të plota dhe të barabarta me shkencëtarët e të gjitha vendeve të Mesdheut, të cilët, nëse doni, mund t'jua rendis. Pra, këto vende kanë aderuar në këtë konventë që në fillimet e shekullit të kaluar. Për shembull, Rumania ka aderuar që në vitin 1925, Serbia në vitin 1927, Turqia në vitin 1928, Qipro, Palestina, Siria, Maroku, Libani kanë aderuar shumë vite më parë dhe më pas kanë aderuar vende, të cilat janë të paktën prej 70 vjetësh në këtë konventë. Shqipëria është një nga vendet e fundit të Mesdheut që pranon të jetë pjesë e kësaj konvente dhe kjo ka ardhur si pasojë edhe e një dakordësie ndërmjet titullarëve të lartë shqiptarë dhe princit të Monakos, i cili vizitoi Shqipërinë para pak kohësh, ku u dakordësua aderimi i Shqipërisë në këtë konventë. Vizita e princit Albert II të Monakos në tetor të vitit 2018 shënoi edhe dakordësinë për të aderuar në këtë konventë nga pala shqiptare. Ne kemi punuar prej një viti dhe realisht sot jemi të kënaqur që kemi mundësinë ta bëjmë edhe Shqipërinë pjesë të këtij rrjeti kaq interesant të diskutimit shkencor.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka relatori, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, kryetar!

Sikurse e paraqiti në mënyrë të detajuar edhe Ministri Klosi, sot kemi një projektligj që propozon aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Ekspozimin Shkencor në Detin Mesdhe, si një nga shtetet që laget nga ky det për të kryer hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det.

Projektligji ka si qëllim të kontribuojë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe deteve, që kontribuojnë në këtë det.

Komisioni Ndërkombëtar për Ekspozimin Shkencor është me seli në Monako, e cila përbëhet nga 23 shtete anëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, ju lutem!

Duke qenë se Deti Mesdhe është një trashëgimi shekullore, shtetet kanë si objektiv të mundësojnë shkëmbimin e standardeve dhe ideve shkencore, por edhe të mbajnë një dialog konstruktiv, paqësor midis tyre, pasi për një kohë të gjatë, ato kanë qenë të ndarë nga konfliktet historike. Miratimi i teknologjive të reja do t'u mundësojë vendeve palë të fitojnë avantazhe konkurruese në treg, pasi shumë prej teknologjive alternative të zhvilluara së fundi kanë si efekt direkt rritjen e eficiencës së energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve. Duke qenë pjesë e këtij projekti Shqipëria do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare të projekteve të vogla dhe të mesme për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Duke e vlerësuar rëndësinë e miratimit të kësaj marrëveshjeje, i ftoj, si relator, të gjithë kolegët që ta miratojmë njëzëri këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Bushka ka një pyetje.

Klotilda Bushka – Zoti Ministër, faleminderit për të gjithë prezantimin! Në fakt, ky është një akt shumë i rëndësishëm në kuadër të të gjitha politikave të përgjithshme për zhvillimin e turizmit, sepse kemi vërtet nevojë për të plotësuar ndoshta edhe vakuumet ligjore në këtë drejtim. Unë kam dy pyetje.

Së pari, në vijim të miratimit të kësaj marrëveshjeje, a kemi nevojë për ndryshime ligjore, që ta bëjnë direkt të zbatueshme?

Së dyti, miratimi i kësaj marrëveshjeje, me sa shpjeguat në relacion, ka një rëndësi të madhe edhe në kuadër të mundësive të përfuturit të ndihmës ekonomike dhe teknike, nëpërmjet një komisioni që është krijuar në vijim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Në qoftë se nuk gabohem, nisma për zhvillimin e qëndrueshëm financiar të zonave të mbrojtura detare të Mesdheut i merr direkt shteti apo i marrin organizma të tjerë? Nëse është sipas modeleve të bashkëfinancimit, a ka efekte financiare? Pra, a do të kontribuojë shteti, në mënyrë që të përfitojë më pas nga këto ndihma? Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Klosi, mund të vazhdoni me përgjigjet e pyetjeve. Më pas fjalën e ka kërkuar për pyetje zoti Gjoni.

Blendi Klosi – Duke vlerësuar relacionin shumë racional të kolegut dhe pyetjet realisht profesionale të koleges, do të doja t'ju siguroja që prezenca e Shqipërisë në këtë grup dhe në

këtë komitet shkencor do të na ndihmojë shumë që ne të jemi pjesë e vlerësimeve të fundit shkencore që ndodhin në të gjithë rajonin.

Në përgjigje të pyetjes suaj, e nderuar kolege, për sa u përket ndryshimeve ligjore, mund të them se specifikisht për këtë marrëveshje nuk ka nevojë për ndryshime ligjore, por për sa i përket turizmit marinë dhe filozofisë sonë për ta hapur këtë turizëm në një shkallë më të madhe, pa dyshim që ka nevojë për ligje të reja, si dhe për ligjet që deri tani kanë qenë të fjetura në administratën publike shqiptare. Unë do të përmend ligjin e lundrimit, si dhe ndryshimet në kodin detar, që kanë të bëjnë me hapjen e turizmit marinë në Shqipëri, si dhe për turizmin e jahteve, të skafeve dhe turizmit detar. Pa dyshim, ka edhe ndryshime të tjera, për të cilat ne do të komunikojnë përsëri me komisionin tuaj, si komision përgjegjës për ndryshimet ligjore, por, natyrisht, edhe në kuadër të politikave të reja që ne duhet të ndërmarrim për sa i përket turizmit detar. Prandaj, realisht kemi nevojë që edhe në këto komisione të jemi më pranë për sa u përket ndryshimeve që po bëjmë në kuadër të turizmit.

Për sa i përket pyetjes suaj të dytë nëse do të kemi përfitime financiare dhe ku do të shkojnë këto përfitime nga qenia pjesë e kësaj konvente, mund të them se tashmë kemi filluar të kemi përfitime nga kjo konventë dhe qenia pjesë e këtij projekti. Sot dy projekte të rëndësishme janë të realitetit shqiptar, një është ai për mbështetjen në zonat e mbrojtura dhe në parkun kombëtar të Karaburunit kemi një projekt të financuar nga ky komitet dhe nga princi i Monakos për sa i përket forcimit të kapaciteteve tona administrative, parkut kombëtar të Sazan – Karaburunit për ta paraqitur atë si një atraksion turistik më të vlefshëm dhe më të aksesueshëm për turizmin.

E dyta, meqenëse pyetët: “Përfiton vetëm shteti, apo edhe shoqatat?”, pa dyshim që edhe shoqatat janë pjesë e këtyre përfitimeve. Madje, sot Shoqata e Pishës Flamur ka marrë një mbështetje nga princi i Monakos për të vazhduar punën shkencore për mbrojtjen e një prej monumenteve më interesante të trashëgimisë natyrore, që është Pisha Flamur, përsëri në zonën e Karaburunit, ku ekspertët e fushës nëpërmjet kësaj fushate dhe shoqate janë mbështetur, pra janë sponsorizuar në kërkimet e tyre të mëtejshme shkencore.

Për të kaluar te pyetja e tretë, që, në fakt, ka lidhje me dy pyetjet e para, kontributi financiar i qeverisë shqiptare në këtë konventë është, natyrisht, minimal (siç paraqitet edhe në relacionin përmbledhës që shoqëron konventën), është vetëm 25 mijë euro nga qeveria shqiptare, e cila ka pranuar ta japë këtë mbështetje buxhetore nëpërmjet buxhetit aktual të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, por dhënia e kësaj mbështetjeje do të na japë mundësinë që të përfitojmë shumë herë më tepër, e thashë, jo vetëm mbështetje financiare të drejtpërdrejtë

për aktivitete të ndryshme në mbrojtje të trashëgimisë natyrore të vendit, por më shumë se kaq, për të qenë edhe pjesë e debatit.

Ju garantoj që, në kuadër të turizmit të marinës dhe të turizmit të detit, por edhe nëpërmjet diskutimeve për këtë konventë, ne kemi filluar të kemi përfitimet e para, duke e parë Shqipërinë si destinacion edhe për turizmin detar. Besoj që jemi realisht të kënaqur nga çfarë kemi përfituar nëpërmjet kësaj konvente, edhe pa qenë pjesë e saj. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Klosi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Gjoni për pyetje.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, së pari, faleminderit për praninë tuaj në këtë komision, e cila dëshmon për seriozitetin që ju i kushtoni kontrollit mbikëqyrës të parlamentit ndaj ekzekutivit, gjë të cilën unë nuk do të isha në gjendje ta thosha për disa kolegë të tjerë të kabinetit qeveritar, të cilët e trajtojnë parlamentin me më pak respekt sesa ju! Kështu që faleminderit nga ana ime!

Dua t'ju bëj një pyetje. Besoj se ky projektligj imponon unitet ndërpartiak ndërmjet opozitës dhe maxhorancës, sepse besoj të gjithë jemi dakord që hulumtimi dhe studimi shkencor më i thellë i Mesdheut, veçanërisht në kuadër të ndryshimeve klimaterike, të ngrohjes globale dhe të ndryshimeve në biodiversitetin e detit Mesdhe, është shumë i rëndësishëm, por, me aderimin e Shqipërisë pranë këtij komisioni ndërkombëtar në Monako, a kemi në vend kapacitete shkencore për të siguruar hulumtimin, studimin dhe punën oqeanologjike në këtë det, apo do të jemi të varur nga ekspertët e huaj që do të vijnë këtu? Pra, dua thjesht të kuptoj se çfarë efektesh praktike ka kjo konventë dhe çfarë përfitimesh do të kemi ne si vend nga hulumtimi i detit Mesdhe në brigjet tona. Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Ministër.

Blendi Klosi – Të nderuar kolegë,

Pa dyshim që ulja në tryeza të tilla shkencore kërkon të kesh edhe kapacitete për të qenë pjesë e këtij diskutimi dhe ju, realisht, e ngrini me shumë të drejtë shqetësimin tuaj që ne, dakord, do të bëhemi pjesë e këtyre konventave, por a do të kemi mundësinë të konkurrojmë me vendet e tjera për të përfituar projekte në kuadër të konventës? Ajo që do të thosha është që, megjithëse vazhdojmë të bëjmë debatet tona politike dhe shpesh ndahemi te politika, unë mendoj që te pjesa e shkencës, te pjesa e studimeve shkencore, te pjesa e përfitimeve që i vijnë Shqipërisë nga shfrytëzimi shkencor dhe ekonomik i burimeve tona natyrore, ne duhet të jemi bashkë. Shumë mirë që edhe ju e ngrini si shqetësim, edhe ne vazhdojmë të bëjmë thirrje; që për pjesën e shkencës të mos kemi ndarje. Ne e kemi trajtuar edhe te “Pakti me universitetin”

dhe vazhdojmë t'i kërkojmë botës akademike, profesoratis të Fakultetit të Shkencave, me të cilin përgjithësisht Ministria e Mjedisit ka gjetur gjuhën e përbashkët, që, kur vjen puna te studimet e përbashkëta, ne të jemi gjithnjë të mirënjohur.

Ju garantoj, i nderuar koleg, që ne kemi profesorë dhe shkencëtarë të vërtetë. Kështu, edhe studimet e tyre në këta 25 vjet jashtë dhe qenia pjesë e një rrjeti ndërkombëtar na garantojnë që ne kemi njerëz të kualifikuar, profesionistë të vërtetë, të cilët kanë arritur që edhe deri tani të përfitojnë nga këto konventa. Prandaj unë kam bindjen e plotë që ne do të jemi jo vetëm të barabartë, por realisht nxitës me njerëzit tanë të shkencës për të qenë konkurrentë me vendet që ju përmenda, të cilat janë pjesë e konventës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Klosi!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi për pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Ministër!

Edhe unë e vlerësoj këtë aderim të Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor të detit Mesdhe.

Ju në relacion keni theksuar që ky komision vepron në gjashtë komitete, pra ka task-forca të ndryshme, zhvillon kongrese dhe takohen ekspertë. Deri diku pyetja që bëri kolegu Gjoni dhe përgjigjja juaj më lanë të kuptoj që Ministria e Mjedisit ka një bashkëpunim me universitetet. Në rastin konkret, përveç universiteteve, këtu ka edhe agjenci kombëtare, ka edhe organizata të shoqërisë civile, si dhe shumë shoqata të cilat veprojnë në Jug të Shqipërisë, qoftë edhe ato për bukuritë nënujore e kështu me radhë. Pa dyshim, aderimi në këtë konventë kërkon një ristrukturim ose një koordinim të mirë të punës së të gjithë këtyre aktorëve, ndaj pyetja ime e parë ka të bëjë pikërisht me universitetet: a keni lidhur marrëveshje, a keni bashkëpunim me të gjitha universitetet që e kanë në profilin e tyre kërkimin shkencor në një nga fushat që lidhet me këtë konventë?

Së dyti, si po punohet me të gjitha shoqatat dhe agjencitë për të koordinuar përpjekjet, kërkimet, por edhe për të përfituar nga ekspertiza që mund të japë ky komision?

Së treti, meqenëse nuk dua ta marr fjalën për diskutim, do të doja t'ju informoja se Kuvendi i Shqipërisë ka nënshkruar 23 marrëveshje me universitete publike dhe jopublike në Shqipëri. Ndoshta do të ishte e udhës që në momentin, kur ju të filloni konsultimin publik të projektligjit “Për ndryshimet në Kodin Detar” apo edhe për nisma të tjera, të ftoheshin edhe këto universitete, profesorati e të tjerë për të qenë pjesë e konsultimit që në momentet e para të inicimit të këtyre ndryshimeve. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Ministër.

Blendi Klosi – Faleminderit, kolege dhe profesoreshë Hysi!

Pa dyshim, edhe *background*-i juaj akademik dhe lidhja juaj e pandashme me universitetin ju çon drejt kësaj pyetjeje, Ministria e Mjedisit dhe e Turizmit e ka praktikë pune që për çdo njërën nga nismat që ndërmerr, qoftë për një projektligj të rëndësishëm apo një projektvendim sado minimalist, në kuadër të politikave të ministrisë ne të kemi konsultim publik me profesoratin dhe me njerëzit e shkencës. Kohët e fundit kemi shënuar një lloj bashkëpunimi shumë të ngushtë me Fakultetin e Shkencave, por edhe pas këtij aktiviteti do të shkoj përsëri në Fakultetin e Shkencave për të pasur një dëgjese publike me ta për nisma shumë të rëndësishme që kemi ndërmarrë në kuadër të reformimit të të gjitha institucioneve mjedisore, politikave të reja që kemi për raportin e lejes mjedisore me mjedisin, me mënyrën se si trajtohen bizneset në kuadër të politikave. Unë e kam bërë një dëgjese me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, por jam i gatshëm të vij edhe në Komisionin e Ligjeve, edhe në kuadër të këtyre politikave që kemi ndërmarrë, për të bërë një debat për sa u përket ndryshimeve ligjore që ne po ndërmarrim në kuadër të nismave reformuese në raport me mjedisin.

Për sa u përket pyetjeve tuaja të drejtpërdrejta, ne kemi një marrëveshje të nënshkruar, të paktën mbi një vit, me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me Fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit dhe, po ashtu, me Universitetin Bujqësor, si dhe me fakultete që kanë lidhje me Ministrinë e Mjedisit.

Ju garantoj, e nderuar kolege, që në punën time të përditshme profesorati është një nga partnerët dhe një nga shtyllat kryesore të bashkëpunimit. Edhe në kuadër të kësaj marrëveshjeje, siç e përmenda pak më parë, ne kemi bashkëpunim edhe me profesoratin nëpërmjet punës që ka bërë Agjencia e Zonave të Mbrojtura për trajtimin dhe rivlerësimin e të gjitha zonave të mbrojtura në përgjithësi dhe zonës së parkut kombëtar Sazan-Karaburun, e cila është një zonë e re e shpallur e mbrojtur, e cila tashmë është nën monitorimin shumë të rreptë të konventave ku ne kemi aderuar në kuadër të zonave të mbrojtura. Nesër do të kemi një dëgjese publike në Korçë për sa u përket të gjitha ndryshimeve që do të bëjmë në kuadër të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura për t'i trajtuar zonat e mbrojtura si vlera natyrore dhe turistike, për të përkufizuar saktësisht cilët janë kufijtë e zonave të mbrojtura dhe pse duhet të jenë zona të mbrojtura, po ashtu, për të pasur mundësinë të vazhdojmë që edhe shoqatat e tjera mjedisore të jenë pjesë e këtij debati.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Klosi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino, një pyetje për ministrin.

Bashkim Fino – E kam për ministrin apo për relatorin, pak rëndësi ka, por e kam edhe për relatorin.

Ulsi Manja – Nuk ka problem.

Bashkim Fino – Jo, ne bëjmë mirë që e nënshkruajmë dhe që e votojmë, por unë dua të di: kur bëhet efektive kjo marrëveshje, pra kur fillon puna tamam? Sepse lexoj këtu dhe më tërheqin vëmendjen nenet 4 dhe 5 të statutit.

Nuk dua të ndalem te neni 4, sepse e tha ministri, është një detyrim dhe kontribut vjetor prej 25 mijë eurosh, që besoj se buxheti i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit e ka edhe për këtë vit, pale pastaj për vitin tjetër, ose për këtë vit i bie të mos paguajë gjë, sepse, sa të miratohet nga ne, sa të miratohet nga Presidenti...

Ndërhyrjen e kam për pjesën tjetër, që ka të bëjë me nenin 5, ku thuhet se çdo shtetas nënshkruar cakton me akt zyrtar të deleguarin e tij. Domethënë, do të jetë një njeri në çdo shtet, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, më falni, se thashë çdo shtetas. Pra, çdo shtet do të ketë një të deleguar të tij kombëtar. Por ndoshta ky i deleguari kombëtar mund të jetë nga bota akademike, për të cilën bëri pyetje edhe zonja Hysi, apo është çështje që ju nuk e keni menduar ende?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni këtu në statut, por nuk e di.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Klosi, ju lutem, një përgjigje. Pastaj do të kalojmë në votim.

Blendi Klosi – Besoj se kjo do të jetë pjesë e negociimit me drejtuesit ligjorë të konventës dhe e nivelit të përfaqësimit që do të duhet të përcaktohet nga çdo vend anëtar. Por, pa dyshim, do të kemi një diskutim edhe me komisionin tuaj, sidomos me relatorin, i cili ka një raport të veçantë me këtë konventë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Shameti!

Faleminderit, zoti Klosi!

Nuk besoj se ka diskutime nga kolegët. Vetë fakti që seanca plenare ka vendosur që ky projektligj të kalojë me procedurë të përshpejtuar, flet për rëndësinë që ka aderimi i shpejtë i Shqipërisë në këtë konventë.

Jemi komision për dhënie mendimi dhe do të duhet që po sot, pas votimit në komision, relatori dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin për komisionin përgjegjës.

E hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet në parim projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në detin Mesdhe”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në detin Mesdhe”. Po sot relatori dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin për t’ia përcjellë komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Me këtë votim e mbyllim këtu mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve.

Shumë faleminderit, zoti Klosi, për prezencën në komision!

Shumë faleminderit, kolegë, dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA